

ORTAKU THEMELUES
AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"DEMA-AL "Sh.p.k

Sot me date 21.01.2022, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise si edhe ne Kodin Civil Republikes se Shqiperise, ne Ligjin Nr.7512 date 10.08.1991, "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit", të ligjit Nr.9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Q.K.B dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare", me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ortaket: vendosen te krijojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **"DEMA-AL" Sh.p.k** me akt themelimi si vijon.

NENI 1
FORMULIMI

Formohet shoqeria me pergjegesia te kufizuar, me emrin **"DEMA-AL" Sh.p.k**. Shoqeria do t'i nenshtrohet Legjislacionit Shqiptar ne fuqi, ndersa deget qe mund te krijohen do t'i nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega (ne rastet e nje shteti tjetër). Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelimi dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"DEMA-AL" Sh.p.k** do te kete seline ne Ballaj, Rrogozhine, perkatesisht , pasuria Nr 139/72ND, ZK 3774, Vol 15, Fq 167, Vilë Ballaj,

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese se përgjithshme të ortakëve.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat që vijojejnë:

Veprimtari tregtare ne fushen e Agroturizmit, Hoteleri, Bar-kafe, restorant, sherbime sociale. Agjensi imobiliare, sherbime komisionere, ndermjetesimi, aktivitet ne fushen e sigurimit te mjeteve dhe prones, shendetit ne udhetim etj

Shoqeria do te zhvilloje sipas mundesive qe do krijohen edhe cdo aktivitet tjetër tregtar që nuk është i ndaluar nga ligji.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e shfrytezimit te ambjenteve me qira, pishina, mbareshtim peshku, peshkim, mbareshtim te shpendeve, kuajve, gjedheve dhe te imtave.

Aktivite te shërbimeve online dhe deliveri, shit-blerje pajisjesh dhe programe kompjuterike, rregullim faqesh internet online, asistence kompjuterike online, krijim faqesh web online, support teknik online, programime, web design online, konsulence network online.



"DEMA-AL" shpk
Gose, Ballaj, Rrogozhine, Shqiperi

Zhvillimin e marketingut digjital duke përfshirë të gjithë deget e saj si psh Social Media Marketing, Email Marketing, Online Adverstising, eComerce, Internet Marketing, Network Marketing, Team Building, Blogging, SEO, Affiliate Marketing, Content Marketing, Video Marketing, Search & Display Marketing, Business Strategies, Wordpress, Shopify dhe të tjera në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera. Zhvillimi I trajnimeve të ndryshme fizikisht në ambientet e shoqërisë ose online, duke zgjedhur opsionin ose në grup ose të personalizuar.

Ushtrimi i aktivitetit të agjensisë ose agjentit tregtar (sipas parashikimeve të nenit 950, e vijuesat të KODIT Civil) dhe çdo aktivitet tjetër të ngjashëm të lejuar nga ligji Shqiptar, në ndërmjetësimin e shitjes së aksioneve, në bursë, pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, sendeve me vlerë.

Çdo veprimtari që ka lidhje të drejtperdrejte ose të tërthorte me veprimtarinë kryesore, Dedikimi i biznesit për ofrimin e çdo lloji shërbimi shitje, rishitjen komerciale, blerje distribuim, transport Brenda dhe jashtë vendit, import eksport, ndërmjetësim për dhënie me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, transport mallrash Brenda dhe jashtë vendit.

NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQËRISË

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1 200 000 (një milionedyqindmije) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme

Ortaku themelues **Z. Albert DEMA**: Zotërues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme 1 200 000 leke, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kontributi i ortakut është në para në Shumen e sipërcituar.

Kontributet në para do të paguhesh plotësisht menjëherë, sapo shoqëria fillon aktivitetin, dmth menjëherë pas rregjistrimit në QKB.

Pagesat e kontributeve në para do të kryhen në bankë dhe në çdo agjensitë tjetër të specializuar dhe të njohur në ligj.

NENI 6

DREJTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, **Z. Albert DEMA** i cili do të jetë përfaqësues ligjorë i shoqërisë dhe administratoree saj. Me vone dhe kurdoherë me miratimin e asamblese së ortakeve do të vendoset për administrator të ri të shoqërisë.

Ajo është përfaqësuesia Shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej saj dhe në rast mungese, nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

NENI 6

VULA E SHOQËRISË

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me tekstin rreth saj.

NENI 11

KRIJIMI I SHOQËRISË

"DEMA-AL" shpk
Gose, Ballaj, Rrogozhine, Shqiperi

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

Ky akt themelimi, u perpilua ne gjuhën shqipe, në 3 (tre) kopje identike me njëra tjetrën, dhe do t'u vihet në dispozicion organeve kompetente.

Një kopje e këtij akt themelimi, do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise me përgjegjësi të kufizuar "**DEMA-AL Sh.p.k.**

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht me vullnet të lirë të ortakëve themelues.

ORTAKU

Albert DEMA

